

**Tirane, 12.11.2014**

**Lenda :** Eksperize ne Pemetari (Luftimi i minjeve)

Adad Malore ne bashkepunim me Drejtorine Bujqesise Korce, nga data 3 –10 Nentor ka realizuar nje mision ekspertize ne pemetari per aspekte te teknologjise dhe te pasvjeljes se frutave, me specialiste te tij dhe specialistin e njohur francez Patrick Hainemman dhe specialiste te saj. Nga vleresimi ne terren, krahas shume arritjeve dhe problemeve, u konstatua prania e minjeve ne pemetore, per te cilin do te flasim me poshte :

#### **Situata ne Korce**

- Nga vzhgimi i pemetoreve ne terren ne rrethin e Korces u konstatua se prania e minjeve ne pemetore eshte e madhe dhe perbejne rrezik per te ardhmen e pemetoreve dhe prodhimit. Minjte ishin shfaqur dukshem, te cilet kishin bere galeri pergjate rreshtave te pemetoreve. Zakonisht ato shfaqen te rrezikshme pas vjeljes, kur nuk kane te hane fruta dhe favorizohen nga prania e barit ne pemetore, i cili ishte shume i pranishem.

#### **Problemi i demtimit te minjeve**

- Demet qe shkaktojne minjte jane te medha sepse demtojne pemem dhe prodhimin
- Ato demtojne kryesisht levoren e pemes
- Demtojne rrenjet e pemes gjate dimrit dhe sidomos pemet e reja, te cilat i thajne plotesisht ne rate te infeksioni te rende.



#### **Menyrat e luftimit :**

- Trajtimi kimik eshte menyra me efikase per luftimin e minjeve: Per luftimin e tyre pergjate rreshtit te pemeve ne cdo 50 m, vendosen tuba me diameter 70-100 mm dhe me gjatesi 40 cm ne menyre qe te kaloj miu dhe te mos laget apo demtohet preparati. Brenda ne tub vendoset preparati storm, klorat, ose kokrra gruri te ziera te pluhurosura me fosfit zingu etj. Miu e merr ushqimin dhe e dergon ne fole dhe atje jep efektin e preparati. Kontrolli behet cdo dite dhe numerohen kokrrat preparatit te vendosure ne tub dhe shikohet se sa kokrra ka marre miu ose jo dhe i zevendeson kokrrat e marra. Ky kontroll vazhdon deri sa te mos ndryshoje numri, qe do te thote se preparati e ka dhene efektin e vet dhe minjte kane ngordhur ne fole.
- Punimi te tokes dhe heqja e barit jane metoda me pak efikase se sa trajtimi kimik.
- Permbytja e gjithë sipërfaqes me uje me ane te ujitjes apo renies se shirave, por qe nuk eshte shume efikase per shkak te veshiresise se ujitjes dhe kushtezimit nga reshjet.

#### **Propozimi :**

- Informimi dhe njohja e fermerve me rrezikun qe shkaktohet nga minjte
- Per luftimin e minjeve duhet te kete nje strategji dhe trajtime, jo vetem kur shfaqen minjte, por duhet te behet ne vazhdimesi, te pakten per 2-3 vite dhe nen monitorim te vazhdueshem.
- Duhet te behet luftimi i minjeve per gjithë blloqet e pemetoreve sepse te luftohet ne menyre te plote.
- Te keshillohen prodhuesit per menyren e luftimit dhe te rekomandohet preparati STORM i "BASF" sepse eshte me i efekshem se preparatet e tjere te cituar me lart.
- Te bashkepunohet me kompanite e inpueteve bujqesore, qe duhet te sjellin ne treg kete produkt te BASF.

**PER DREJTORINE E BUJQESISE KORCE**

Arben MALO

DREJTOR

**ADAD MALORE**

Hafuz DOMI

DREJTOR